

VENDIM
Nr. 506, datë 30.6.2026

PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 80 (tetëdhjetë) apartamenteve në 1 (një) ndërtesë me njësi banimi (pallat), përkatësisht, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e të dhënave për Godinën 7 (Seksioni A) në zonën e re zhvillimore "Kombinat"

Nr.	Emërtimi i Kontratës	Vlera e Objektivit sipas Kontratës (Ndërtim+Montim+Projektim) (lekë pa t.v.sh)	Vlera e Sitacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim) (lekë pa t.v.sh)	Vlera e Studim Projektimit (lekë pa t.v.sh)	Vlera e Mblotqyrjes së Punimeve (lekë pa t.v.sh)	Vlera e Kolandimit të Punimeve (lekë pa t.v.sh)	Vlera Totale e Investimit (lekë pa t.v.sh)	Sipërfaqe Total Ndërtimi (m ²)	Sipërfaqe Banimi Bruto Ap. (m ²)	Sipërfaqja e Katit -1 (m ²)	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)
1	Banesë kolektive Godina 7 (Seksioni A)	512.482.994	504.423.428	8.047.559	3.578.000	135.000	516.183.987	10.334.50	7.697.38	2.430.43	35	40	5	80